



Prishtinë, 13.06.2018
Kodi i ZRRE-së: V_1002_2018

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Bazuar në:

- Dispozitat e Neneve 15 dhe 26 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë,
- Dispozitat e Nenit 16 të Rregullës për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë,
- Dispozitat e Neneve 3 dhe 7 të Licencës për Operatorin e Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike,
- Kërkesën e KQKO për amandamentimin e dokumentit “Kodi i pajisjeve elektrike” të datës 09.02.2018,

në seancën e mbajtur me datë 13.06.2018, nxori këtë:

VENDIM

- I. **APROVOHET** amandamentimi i dokumentit “Kodi i pajisjeve elektrike” të KOSTT Sh.a., si në shtojcë të këtij vendimi.

Arsyetim

- Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) me datë 09.02.2018 ka pranuar kërkesën e KQKO për amandamentimin e dokumentit “Kodi i pajisjeve elektrike” të harmonizuar me legjislacionin në fuqi. Me këtë rast po ashtu janë bërë disa plotësim-ndryshime të pikave si edhe përmirësime gjuhësore dhe rregullime të tekstit.
- ZRRE ka dhënë komente gjatë periudhës amandamentuese si pjesëmarrëse aktive në KQKO.
- Pas këtyre zhvillimeve, KQKO ka amandamentuar dokumentin në harmoni me ndryshimet ligjore, dhe ka bërë kërkesë zyrtare në ZRRE për Arovimin e amandamentimit të dokumentit “Kodi i pajisjeve elektrike”.
- Bordi i ZRRE-së, pas analizimit të dokumentit, ka vlerësuar se amandamentimet e dokumentit janë në harmoni me legjislacionin e sektorit të energjisë në Kosovë dhe përmes këtij vendimi



ka **aprovuar** amandamentimet e dokumentit “Kodi i pajisjeve elektrike”.

- Të gjitha dispozitat tjera të dokumentit “Kodi i pajisjeve elektrike” do të mbesin në fuqi.

II. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.

III. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së, ku do të publikohet edhe dokumenti. Dokumenti do të publikohet edhe në faqen elektronike zyrtare të KOSTT.


Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund ti drejtohet Gjykatës Kompetente brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Shtojcë: *Dokumenti i amandamentuar “Kodi i pajisjeve elektrike”.*


Vendimi i dërgohet:

- Të licencuarit KOSTT Sh.A.
- Arkivit të Zyrës së Rregullatorit për Energji

Bordi i ZRRE-së:


Arsim Janova, u.d. Kryesues


Besim Sejfiqaj, anëtar


Selman Hoti, anëtar


Izet Rushiti, anëtar